



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.430/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit R.Xh., për shkak të veprave penale: I. Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm të parashikuar nga neni 375 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), dhe, II. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.417/2017, të datës 03.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 27.06.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasa Radovic, të pandehurit R.Xh. dhe mbrojtësit të tij av. G.R., të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 28.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R.Xh., nga i ati A., e ëma Xh., e vajzërisë A., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin V. - komuna e ..., ku edhe tani jeton, pensionist i parakohshëm i Trepçës, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personal *numri personal...*, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

I. Me datë 02.06.2017 rreth orës 05:50 minuta, në fshatin V., komuna e ..., në udhëkryqin para shtëpisë së tij, i pandehuri ka përdorë armën në shkelje me ligjin e zbatueshëm, ashtu që derisa i dëmtuari S.D., ishte duke lëviz me automjetin e tij, së bashku me vëllaun e tij, A.D., i pandehuri iu del përpara automjetit, e ndal automjetin dhe ju drejtohet me fjalët “çka po më kqyrni” dhe menjëherë fillon t’i shaj me fjalët “ ta q... nanën, ta qinisi në ballë” dhe ka nxjerrë revolën me ngjyrë të bardhë të markës “M47” me numër serik 215930 të kalibrit 7.62x25 mm dhe e ka drejtuar në drejtim të dëmtuarit S.D., më pas ka ndërhyrë vëllaun i të dëmtuarit - dëshmitari A.D. dhe e ka larguar të pandehurin, e ku i pandehuri shkon në shtëpi dhe e fsheh armën në një lule në oborr, e cila armë është gjetur pastaj nga ana e Policisë dhe është konfiskuar.

Me këtë ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës spo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-ës.

II. Me datë 02.06.2017 rreth orës 06:10 minuta, në fshatin V., komuna e ..., i pandehuri R.Xh., ka mbajtur në pronësi dhe ka poseduar armë në shkelje të ligjit lidhur me armët e tilla, ashtu që pas marrjes së informatës nga policia, ku i dëmtuari S.D. kishte lajmëruar policinë se ka qenë i kërcënuar nga i pandehuri siç është cekur në pikën I të dispozitivit, atëherë policia ka shkuar në shtëpinë e të pandehurit dhe aty kanë gjetur armë: një pushkë e gjuetisë modeli “Bolt Rifle” prodhim Chinese me nr. serik 273178 të kalibrit 7.62 mm, një pushkë të gjuetisë moeli “Over

Under” prodhim turk me nr. serik 143391 të kalibrit 12 GA, një pistoletë M57 me nr. serik 215930 kalibër 7.62x25 mm, dy karikator, 18 fishek dhe një fotroll si dhe dy leje të armëve të gjuetisë me afat të skaduar.

Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, 62, 69, 73, 74, e 75 të KPRK-se, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

GJYKON

Për pikën I, për veprën penale: Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-ës, i cakton dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi

Për pikën II, për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i cakton dënim me gjobë në shumën prej 550€ (pesëqind e pesëdhjetë euro).

Gjykata, në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, të pandehurit R.Xh., i:

S H Q I P T O N

1. Dënim unik me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
2. Dënim unik me gjobë në shumë prej 550 € (pesëqind e pesëdhjetë euro) të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 3 (tre) këste të barabarta. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Në mbështetje të nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 të KPRK-së dhe nenin 282 par.2 nenpar.2.1 të KPP-se, të pandehurit i shqiptohet:
Dënim plotësues - Konfiskimi i sendeve dhe atë:
 - a. një pushkë e gjuetisë modeli “Bolt Rifle” prodhim Chinese me nr. serik 273178 të kalibrit 7.62 mm.
 - b. një pushkë të gjuetisë modeli “Over Under” prodhim turk me nr. serik 143391 të kalibrit 12 GA.
 - c. një pistoletë M57 me nr. serik 215930 kalibër 7.60x25 mm, dy karikator, 18 fishek dhe një fotroll si dhe dy leje të armëve të gjuetisë me afat të skaduar, dhe
 - d. Një revole me ngjyrë të bardhë të markës “M47” me numër serik 215930 të kalibrit 7.62x25 mm.

- e. Urdhërohet Policia e Kosovës që armët si në pikën 3 t'i shkatërroj sipas procedurave dhe standarde ligjore.
4. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. I dëmtuari, S.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr 417/2017 të datës 03.07.2017, ndaj të pandehurit R.Xh. nga ... për shkak të veprave penale: I. Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së, dhe II. Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale, nuk më ka ndodhur asnjëherë më parë po ashtu premtoj që nuk do të ndodhë as në të ardhmen, jemi gjashtë anëtarë punoj vetëm unë në familje dhe jam mbajtës i vetem familjes, e lus Gjykatën që të ketë parasysh këto fakte dhe të merr parasysh këto rrethana me rastin e caktimit të denimit.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se në bazë të nenit 248 par.2 të KPP-së duke pasur parasysh pranimin e fajësisë, konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga paragrafi 1 i këtij neni, dhe se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare pa presion andaj Gjykatës i propozoj që të pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim të fajësisë të merr si rrethanë lehtësuese më rastin e caktimit të denimit, po ashtu ky pranim është i bazuar në provat materiale mbi të cilat është ngritur aktakuza si dhe të merr parasysh edhe faktin se i pandehuri nuk ka kryer veper tjetër penale si dhe gjendjen materiale të të pandehurit.

Mbrojtësi av. G.R., lidhur me pranimin e fajësisë deklaron se, edhe mbrojtja i propozon Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë, nga aryeja se ky pranim i fajësisë është bërë në baza vullnetare, pas konsultimit me mbrojtësin pa presion e pa kercenim nga jashtë. Ky pranim i fajësisë perputhet edhe me provat materiale të cilat gjindet në shkesat e lëndes. Prokuroria i ceku disa rrethana lehtësuese të cilat i pranon edhe mbrojtja e posaqerisht të vlersohet fakti se i akuzuari është i gjendjes së dobët shëndetsore dhe ka dhënë një premtim të sinqerte se kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit që do të bijë në konflikt me ligjin.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor i datës 02.06.2017; Deklarata e të pandehurit R.Xh. dhënë në polici e datës 07.05.2014; Deklarata e të dëmtuarit S.D. dhënë në polici e datë 02.06.2017; Deklarate e dëshmitarit A.D. dhënë në polici me datën 02.06.2017; Lista e armëve të konfiskuara e datë 02.06.2017; Raporti i këqyrjes së vendit të

ngjarjes i datës 02.06.2017; Raporti i Agjencisë per forenzikë i datës 30.06.2017; Foto dokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindese për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale: Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së, për të cilën veprën është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, si dhe veprën penale: Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprën e kishte kryer me dashje, si dhe faktin e numrit të armëve të gjetura.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, gatishmërinë e të pandehurit për tu përgjigjur për veprën, rrethanat personale të kryerësit duke e ditur se i njëjti është mbajtës i familjes, prind, është penduar thellë për këtë veprën dhe premtion që në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprën tjetër penale, faktin se për disa armë ka pasur leje mirëpo të njëjtat leje i kanë skaduar si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitivë të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Gjykata, si në dispozitivin e Aktgjykimit ndaj të pandehurit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues – marrjen e sendit, respektivisht armëve, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale sic vertetohet me lartë, në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nenpar.2.1 të KPP-es, es ku përcakton se armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 371 deri me 376 të Kodit Penal, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 69 i KPRK-së, përcakton se sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes

se veprës penale do te konfiskohen, andaj per shkak te këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitivë të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.430/2017 dt.28.06.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.